

Analizë
post
zgjedhore:
Vota dhe
të rinjtë



**QENDRESA
QYTETARE**



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES
www.isp.com.al



CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS

Ky botim u prodhua në kuadër të nismës “Votoj Sepse” mbështetur financiarisht nga Bashkimi European. Përmbajtja e tij është përgjegjesi vetëm e Qendreses Qytetare dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit European.

Përmbajtje


- 1. Hyrje**
- 2. Pjesëmarrja e të rinjve në zgjedhjet e 25 prillit**
- 3. Perceptimi i të rinjve mbi sistemin zgjedhor**
- 4. Pritshmëritë e të rinjve ndaj partive dhe deputetëve të rinj**

1. Hyrje


Të rinjtë në Shqipëri përbëjnë rreth 1/3 e popullsisë më aktive dhe si të tillë kanë një rol thelbësor në proceset zgjedhore dhe demokratike të vendit. Qëndresa Qytetare gjatë fushatës dhe zgjedhjeve të 25 prillit analizoi disa komponentë të zgjedhjeve, përfshi pjesëmarrjen e të rinjve, përfaqësimin e të rinjve në listat zgjedhore dhe në vendet e parlamentit, ku rezultoi se vetëm 2 nga 140 deputetët e ardhshëm do i përkasin moshës 18 – 29 vjeç. Pavarësisht vëmendjes së ulët ndaj të rinjve, nëpërmjet kësaj analize Qëndresa Qytetare synon të matë perceptimet dhe të zbulojë opinionet e të rinjve mbi votën, sistemin dhe partitë politike, pas përfundimit dhe shpalljes së rezultateve zgjedhore nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kjo analizë i shërben vendimmarrësve dhe aktorëve që punojnë në fushën e rinisë për të cuar energjitë tek nevojat që ka kjo kategori në raport me proceset zgjedhore.

Në funksion të analizës Qëndresa Qytetare hartoi dhe shpërndau një pyetësor të plotësuar nga 300 të rinj nga 4 qarqe të vendit lidhur me perceptimin tyre për votën. Të rinjtë u pyetën 2 muaj pas ditës së zgjedhjeve, me një set pyetjesh duke lejuar shpërndarjen e anketës vetëm në 4 qarqe, konkretisht, anketimi u shtri në qarqet: Tiranë, Elbasan, Durrës dhe Shkodër.


Mosha e të anketuarve ishte 18 – 29 vjeç, nga të cilët 52% e të pyeturve ishin vajza dhe 48% djem. Rreth 76.2% e të pyeturve ishin me arsim universitar ose pasuniversitar, ndërsa 23.8% e tyre me arsim të mesëm ose fillor.



79.8% e të rinjve të pyetur nuk bënë pjesë në forcat politikë, ndërsa 20.2% e tyre ishin pjesë e partive politike garuese në zgjedhjet e 25 Prillit.




Ndërkohë 57.7% e atyre që ishin pjesë e forcave politike, janë bërë pjesë për shkak të besimit që kanë pasur tek programi i tyre.




Pyetëtori u hartua nga ekspertë të fushës dhe u testua paraprakisht nga një grup të rinjsh përpara se të shpërndahej.

2. Pjesëmarrja e të rinjve në zgjedhjet e 25 prillit



Në zgjedhjet e 25 prillit votuan 758 368 të rinj të moshës 19 – 29 vjeç ose 45.6% e totalit të votuesve. Pavarësisht shifrave, numri i votuesve të rinj 19 – 29 vjeç ra prej vitit 2017 me 5.2%. Kjo rënie mund të shpjegohet nga shumë faktorë, përfshi edhe mbylljen e kufijve me disa shtete fqinjë ku numri i emigrantëve shqiptarë është i lartë si rasti i Greqisë për shkak të pandemisë por edhe me indiferencën e kësaj grupmoshe për të ushtruar të drejtën e votës.




Bazuar në gjetjet e pyetësorit, 92.9% e të rinjve janë shprehur se kanë marrë pjesë në zgjedhjet e 25 prillit, ndërsa 7.1% u shprehën se refuzuan të marrin pjesë në këto zgjedhje.




71.6% e të rinjve që votuan e konsiderojnë votën si përgjegjësi qytetare ndërsa 19.8% votuan sepse besonin se zgjedhjet sjellin ndryshim. 8.6% nuk janë përgjigjur kësaj pyetje.

Qasja e të rinjve ndaj votës dhe arsyeve që i cojnë në kutitë e votimit duket pozitive dhe motivuese pavarësisht besimit të ulët që të rinjtë kanë sot ndaj partive politike apo liderëve të tyre.

Numri i të rinjve skeptikë mbi procesin e numërimit të votës së tyre është relativisht i lartë. 21% e të rinjve që morën pjesë në zgjedhje mendojnë se vota e tyre nuk u numërua drejt, 48.1% kanë besim të procesi i numërimit ndërsa 30.9% e tyre nuk i janë përgjigjur pyetjes. Nisur nga matjet e




realizuara nga Qëndresa Qytetare ditën e zgjedhjeve, besimi i të rinjve te procesi i numërimit ishte më i lartë se pas një periudhë dy mujore. Shkak mund të jenë bërë kontestimet nga opozita dhe mungesa e transparencës sa i përket numërimit të votave të listës së kandidatëve brenda forcave politike.




Këtë fenomen e tregon dhe fakti që vetëm 70.2% e të pyeturve nga 92.9% do të merrnin sërish pjesë në zgjedhje. 22.7% mund të kenë pësuar zhgenjim nga procesi, rezultatet ose kontestimet e vazhdueshme.

3. Perceptimi i të rinjve mbi sistemin zgjedhor


Ndryshimet e sistemit zgjedhor, në kuadër të marrëveshjes së 5 qershorit, u aplikuan për herë të parë në zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit 2021. Listat gjysëm të hapura mundësuan votën preferenciale për kandidatët. Pavarësisht pritshmërive që mund të kishin ditën e votimeve, 2 muaj pas zgjedhjeve 52.4% e të rinjve shprehen se ndryshimet e sistemit zgjedhor nuk favorizuan kandidatët e rinj, 23.8% mendojnë se kandidatët e rinj u favorizuan nga ky sistem. Ndërsa 23.8% e të rinjve nuk kanë informacion mbi këtë çështje.





57.1% e të rinjve nuk janë të kënaqur me ndryshimet që solli sistemi i ri në listat e deputetëve, 20.2% janë të kënaqur dhe vetëm 1.2% janë shumë të kënaqur.

21.4% e të rinjve janë të painformuar mbi renditjen në listat e kandidatëve për deputetë. Kujtojmë këtu që në zgjedhjet e 25 Prillit vetëm 3 kandidatë thyen herësin duke rrëmbyer mandatin pavarësisht listës së vendosur nga partia dhe një prej tyre i përkiste grupmoshës së re 18 – 29 vjeç.




Fleta e votimit shkaktoi shumë debate mes forcave politike dhe mes ekspertëve zgjedhore nëse do duhej të ishte me numra apo me emra. 74% e të rinjve e vlerësuan si të lehtë fletën e formën e re të votimit, 20% si të komplikuar dhe 6% nuk kishin një opinion mbi këtë çështje. Por pavarësisht këtij rezultati, 76.2% e të pyeturve janë shprehur se do të donin që fleta e votimit në zgjedhjet e ardhshme të përmbante të gjithë emrat e kandidatëve, ndërsa 9.5% janë pro fletës së përdorur në

zgjedhjet e 25 prillit. 14.3% e të rinjve nuk kanë një opinion mbi këtë çështje.


4. Pritshmëritë e të rinjve ndaj partive dhe deputetëve të rinj

Gjatë fushatës së zgjedhjeve të 25 prillit partitë politike nuk treguan kujdes të shtuar ndaj përgatitjes së programeve të mirëfillta me tregues kohorë dhe financiarë por u fokusuan vetëm tek disa deklarata në formë video apo


fjalime të liderëve politikë, të trumbetuara si programe elektorale. Pavarësisht kësaj, të rinjtë shprehin skepticizëm sa i takon pritshmërive të tyre ndaj partive politike që kanë votuar ose jo. 72.6% e të rinjve nuk besojnë se partia fituese e zgjedhjeve do të mbajë premtimet e dhëna për rininë, 19% besojnë se ajo do t'i mbajë premtimet dhe 8.3% nuk kanë një opinion mbi këtë çështje.




Të rinjtë shqiptarë presin që parlamenti i ri të adresojë disa nga problematikat kryesore që prekin rininë në vend. 20.2% e të rinjve presin që parlamenti i ri të trajtojë me prioritet frenimin e emigracionit të të rinjve, 25% e tyre presin që parlamenti i ri të trajtojë me prioritet çështjet e arsimit dhe punësimit të të rinjve ndërsa 28.6% nuk presin që Kuvendi i ri t'i trajtojë me prioritet çështjet që prekin të rinjtë. 26.2% e të rinjve besojnë se Parlament i ri do ti trajtojë të gjitha këto çështje me prioritet.



Në Kuvendin e ri do të ulen vetëm dy deputetë të rinj, një nga Partia Socialiste dhe një nga Partia Demokratike. Asnjë prej dy të rinjve nuk vijnë nga radhët e forumeve rinore dhe nuk kanë kontribut në shoqërinë civile më përpara. 69% e të rinjve të pyetur shprehin se nuk ndihen të përfaqësuar nga deputetët e rinj në Kuvend, 11.9% ndihen të përfaqësuar dhe 19% nuk kanë një qëndrim mbi ata.



Ndërkohë 61.9% e të rinjve besojnë se deputetët e rinj do ta përfaqëojnë rininë njëlloj si ata të legjislaturës së kaluar, 28.6% besojnë se do e përfaqësojnë më mirë dhe 9.5% më keq se deputetët e rinj në legjislaturën 2017 – 2021.



Gjetjet kryesore

- Në zgjedhjet e 25 prillit votuan 758 368 të rinj të moshës 19 – 29 vjeç ose 45.6% e totalit të votuesve. Pavarësisht shifrave, numri i votuesve të rinj 19 – 29 vjeç ra me 5.2%, krahasuar me zgjedhjet e vitit 2017.
- 52.4% e të rinjve shprehen se ndryshimet e sistemit zgjedhor nuk favorizuan kandidatët e rinj, ndërsa 57.1% e tyre nuk janë të kënaqur me ndryshimet që solli sistemi i ri në listat e deputetëve.
- Pavarësisht se 74% e të rinjve e vlerësuan si të lehtë formën e fletës së votimit, 76.2% e të pyeturve shprehen se do të donin që fleta e votimit në zgjedhjet e ardhshme të përmbante të gjithë emrat e kandidatëve, jo vetëm numrat e tyre.
- 72.6% e të rinjve nuk besojnë se partia fituese e zgjedhjeve do të mbajë premtimet e dhëna për rininë, 19% besojnë se ajo do t'i mbajë premtimet dhe 8.3% nuk kanë një opinion mbi këtë çështje.
- 69% e të rinjve shprehen se nuk ndihen të përfaqësuar nga deputetët e rinj në Kuvend, ndërkohë 61.9% e të rinjve besojnë se deputetët e rinj do ta përfaqësojnë rininë njëlloj si ata të legjislaturës së kaluar, 28.6% besojnë se do e përfaqësojnë më mirë dhe 9.5% më keq se deputetët e rinj në legjislaturën 2017 – 2021.

Rekomandime

- Partitë politike dhe KQZ duhet të ndryshojë formën e fletës së votimit nga ajo me numra në një fletë që të përmbajë emrat e të gjithë kandidatëve për deputetë në një zonë zgjedhore të caktuar.

- Partitë politike duhet të krijojnë një mjedis më të hapur dhe konkurues për të rinjtë brenda forcës së tyre politike në mënyrë që të rrisin besimin e votuesve të rinj si dhe të harmonizojnë prurjet e reja me pritshmëritë rinore ndaj tyre.

- Deputetët e rinj duhet të krijojnë marrëdhënie të drejtpërdrejta me grupimet rinore në qarqe për të mundësuar adresimin dhe parlamentarizimin e problematikave të tyre në Kuvend.

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, institucionet me ndikim, media dhe aktorët e shoqërisë civile, në periudhën midis zgjedhjeve duhet të nxisin informimin dhe sensibilizimin e votuesve të rinj për sistemin zgjedhor, sistemin përfaqësues, procedurat e votimit dhe rëndësinë e tij.

